

210 BOTIMI, SHPËRNDARJA ETJ.

Fusha përmban të dhëna për botimin, shpërndarjen dhe prodhimin e njësisë, përfshirë datat përkatëse. Fusha përputhet me zonën e botimit, shpërndarjes etj. të ISBD-së.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
210	Botimi, shpërndarja etj.	nr
	a <i>Vendi i botimit, shpërndarjes etj.</i>	r
	b <i>Adresa e botuesit, shpërndarësit etj.</i>	r
	c <i>Emri i botuesit, shpërndarësit etj.</i>	r
	d <i>Viti i botimit, shpërndarjes etj.</i>	nr
	e <i>Vendi i prodhimit</i>	r
	f <i>Adresa e prodhuesit</i>	r
	g <i>Emri i prodhuesit</i>	r
	h <i>Viti i prodhimit</i>	r

Tek burimet në vazhdim fusha është e përsëritshme.

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<i>Renditja e të dhënave për botuesin</i>
	□	<i>Nuk përdoret / Botuesi i parë i disponueshëm</i>
	0	<i>Botuesi i ndërmjetëm</i>
	1	<i>Botuesi aktual ose i fundit</i>
2		<i>Lloji i shpërndarjes</i>
	□	<i>Përgatitur në disa kopje, zakonisht botuar ose shpërndarë publikisht</i>
	1	<i>Nuk është botuar ose shpërndarë publikisht</i>

Treguesi i parë përcakton nëse botuesi, shpërndarësi etj. ose vendi dhe viti i botimit është i pari, i ndërmjetmi ose aktual. Vlera "0" dhe "1" përdoret vetëm për burimet në vazhdim, ndërsa te burimet e tjera përdoret vlera *zbrazët*.

Për burimet në vazhdim te katalogimi i parë përdoret vlera *zbrazët*. Të dhënën, të cilës i keni përcaktuar vlerën *zbrazët*, nuk duhet ta ndryshoni, përveç në rastet kur e dhëna është gabim ose më vonë arrijnë numrat me periudhën më të hershme të burimit në vazhdim me të dhëna ndryshe për botuesin.

Kur ndryshon botuesi ose vendi i botimit, mund të vendosni të dhënat shtesë për botuesin, që kanë të bëjnë me botuesin e parë ose të ndërmjetëm. Në këtë rast vlera e treguesit të parë është "0".

Kur ndryshon botuesi ose viti i botimit, mund të vendosni të dhënat aktuale të botuesit. Në këtë rast vlera e treguesit të parë është "1".

Vlera "1" e treguesit të dytë përcakton veprën e pabotuar, p.sh. dorëshkrim (shih shembujt 15, 16, 17).

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

210a Vendi i botimit, shpërndarjes etj.

Vendi i botimi ose i shpërndarjes në formën siç është në njësi. Nëse vendi nuk është mjaftueshëm i njohur, është shënuar gabimisht ose është në formë të stërvjetëruar, brenda kllapave katrore mund të bëhet shënim sipas rregullave të ISBD-së (shih shembujt 2, 3, 24). Nënfusha përsëritet për çdo vend botimi shtesë (shih shembujt 5, 7, 25, 28, 39) ose për çdo vend botimi në gjuhë tjetër (shih shembujt 13, 26).

210b Adresa e botuesit, shpërndarësit etj.

Adresa e botuesit ose shpërndarësit shënohet kur botuesi nuk njihet mjaftueshëm (shih shembujt 4, 23). Kllapat katrore vendosen në mënyrë automatike.

210c Emri i botuesit, shpërndarësit etj.

Emri i botuesit ose shpërndarësit, i cili mund të jetë edhe në formë të shkurtuar për aq sa mund të njihet (shih shembullin 1). Pas emrit të shpërndarësit, në kllapa katrore mund të shtohet termi "distributer" ose termi tjetër përkatës në gjuhë tjetër (shih shembujt 5, 28).

210d Viti i botimit, shpërndarjes etj.

Viti i botimit, viti i përafërt i botimit (shih shembullin 26), viti i së drejtës së autorit (shih shembujt 7, 34, 37) ose viti i prodhimit (shih shembullin 11). Mund të vendoset viti kur ka filluar të botohet (shih shembullin 6) ose periodha kohore (shih shembujt 10, 32, 38).

210e Vendi i prodhimit

Vendi i prodhimit të njësisë, p.sh. vendi ku është shtypur (shih shembujt 9, 28, 40). Nëse vendi nuk është mjaftueshëm i njohur ose është shënuar gabimisht, brenda kllapave katrore mund të bëhet shënim sipas rregullave të ISBD-së.

210f Adresa e prodhuesit

Adresa e prodhuesit shënohet nëse prodhuesi nuk është mjaftueshëm i njohur (shih shembullin 30).

210g Emri i prodhuesit

Emri i prodhuesit (p.sh. shtypshkronja) që mund të jetë edhe në formë të shkurtuar (shih shembujt 9, 26, 38, 41).

210h Viti i prodhimit

Viti i prodhimit të njësisë, kur plotëson vitin e botimit (shih shembujt 12, 26).

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Të dhënat vendosen në atë formë dhe rënditje siç e përcakton standardi ISBD. Shenjat e pikësimit ndërmjet nënfushave vendosen në mënyrë automatike, përveç nënfushave me të dhëna paralele. Të dhënat për prodhimin shfaqen në kllapa rumbullake. Lidhja midis nënfushave dhe elementeve të ISBD-së duket në tabelën poshtë.

NËNFUSHA	EMRI I ELEMENTIT	PIKA ISBD(G)	SHENJA E PIKËSIMIT
a	Vendi i botimit, shpërndarjes etj.	4.1	zonë e re
a (e përsërit.)	Vendi tjetër i botimit	4.1	;
c	Emri i botuesit, shpërndarësit etj.	4.2	:
d	Viti i botimit, shpërndarjes etj.	4.4	,
e	Vend i prodhimit	4.5	(
e (e përsërit.)	Vend tjetër i prodhimit	4.5	;
g	Emri i prodhuesit	4.6	:
h	Viti i prodhimit	4.7	,)

Përsëritshmëria e fushave

Fusha është e përsëritshme për burimet në vazhdim, të cilat kohë pas kohe ndryshojnë, në mënyrë që në regjistrim të përfshihen të dhënat për botuesin e parë dhe atë aktual. Gjithashtu, mund të përfshihen edhe të dhënat për botuesin e ndërmjetëm (shih shembujt 18–22 dhe 43–47).

Fushat e përsëritshme 210 japin informacion për veprimtarinë e mëvonshme të botuesve të ndryshëm dhe/ose vendet e botimit në periudhën e caktuar kohore.

Të gjithë emrat e vendeve dhe botuesve që shfaqen në botimin e parë të burimit duhet të shënohen në fushën e parë 210. Nëse ndryshimi ka të bëjë vetëm me një botues, të gjithë emrat e vendeve dhe botuesve duhet të shënohen në fushën tjetër të përsëritshme 210 (shih shembullin 18).

Data në fushën e parë 210 tregon komplet periudhën e botimit të një burimi: vitin e fillimit dhe të mbarimit të botimit (siç është e paraqitur në nënfushat 100c dhe 100d), pavarësisht nga ndryshimi i botuesit dhe/ose vendit të botimit. E dhëna, se kur një botues ka filluar dhe ka ndalur së botuari burimin, duhet të vendoset në fushën e parë të përsëritshme 210, në të cilën vlera e treguesit të pare është "0".

Fushat e përsëritshme 210 plotësohen vetëm nëse të dhënat janë të sakta. Nëse keni vetëm emrat e botuesve, ndërsa periudhat e botimit nuk i dini, për ata bëhet shënim në fushën 300. Kur të dhënat i dini vetëm për disa vite të botimit ose e dini vetëm vitin e fillimit dhe të përfundimit të botimit, shënoni një periudhë të përafërt (shih shembullin 47).

Të dhënat paralele

Sipas ISBD-së, të dhënat paralele (të dhënat e përsëritura në një gjuhë dhe/ose shkrim tjetër) që ndodhen në njësi identifikohen me shenjën e barazimi. E dhëna e caktuar paralele shënohet në nënfushën e përsëritshme, ndërsa para të dhënave vendoset shenja e barazimit dhe hapësirë "=" (shih shembullin 27). Te grupet me të dhëna paralele fillimisht vendoset grupi i të dhënave në njëren gjuhë dhe/ose shkrim dhe më pas në tjetrën/tjetrin (shih shembujt 13, 26, 42).

Përmbajtja e nënfushave

Nëse vendi dhe/ose emri i botuesit nuk dihen, në nënfushën a përkatësisht c, në kllapa katrore vendoset shkurtesa "S. l." (sine loco) përkatësisht "s. n." (sine nomine) (shih shembujt 3, 9, 11, 29) ose termi përkatës në shkrim jolatin (shih shembullin 40).

Nëse janë disa botues, ata vendosen në nënfushat e përsëritura c. Para çdo botuesi vendoset vendi përkatës i botimit në nënfushën e përsëritshme a (shih shembujt 5, 12, 28, 39). Nëse vendet ose botuesit në vazhdim nuk dëshironi t'i vendosni, shënoni shkurtësën "etc." (shih shembujt 10, 37) ose termin përkatës në shkrim jolatin, në kllapa katrore (shih shembullin 41).

Vitet

E dhëna për vitin e botimit është e detyrueshme. Nëse viti i botimit nuk dihet, në nënfushën d vendoset viti i të drejtës së autorit (copyright) ose viti i prodhimit me shpjegimin përkatës (shih shembujt 11, 37). Nëse asnjëra nga këto të dhëna nuk ekziston, në kllapa katrore shënohet viti i përafërt i botimit (shih shembullin 26).

Nëse përkrah vitit të botimit shënohet edhe viti i të drejtës së autorit (copyright), të dy vitet vendosen në nënfushën d, dhe ndahen me presje (shih shembullin 34). Viti i prodhimit, përkatësisht i shtypjes, i cili shënohet përkrah vitit të botimit, vendoset në nënfushën h (shih shembullin 12). Në nënfushën d ose h mund të shënohet periudha kohore (shih shembujt 10, 32, 38).

Te njësitë në disa vëllime/pjesë që botohen më shumë se një vit (në nënfushën 100b është kodi "g"), në nënfushën d me anë të kllapave këndore "<>" tregohet se e dhëna është e përkohëshme (shih shembullin 32). Të dhënat e përkohëshme ndryshohen pas çdo botimi të vëllimit/pjesës në vazhdim. Pas botimit të vëllimit/pjesës së fundit kllapat këndore fshihen. E dhëna në nënfushën 210d duhet të përputhet me të dhënat në nënfushën 100c – *Viti i botimit 1* përkatësisht 100d – *Viti i botimit 2*, si dhe me të dhënat për numrin e vëllimeve/pjesëve në nënfushën 215a – *Përcaktimi specifik i materialit* (shih shembujt 32, 33).

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

100cd TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PËRPUNIMIN, *Viti i botimit 1, Viti i botimit 2*

Nënfushat 100c dhe 100d përmbajnë vitin e botimit varësisht nga kodi në nënfushën 100b (shih shembujt 24, 26, 32, 33, 34, 35, 37, 38).

102 SHTETI I BOTIMIT OSE I PRODHIMIT

Fusha përmban kodin për një ose disa shtete të botimit ose prodhimit të njësisë (shih shembujt 25, 37, 41).

205 TË DHËNAT PËR BOTIMIN

Fusha përmban të dhëna për botimin. Viti i shtypjes, rishtypjes etj. mund të jenë pjesë e të dhënave për botimin apo rishtypjen.

620 KËRKIMI ME VEND TË BOTIMIT

Nëse dëshironi të mundësoni kërkimin me vendin e botimit ose prodhimit, në fushën 620 duhet të vendosni emrin e vendit (shih shembullin 36).

SHEMBUJ

1.

210 □□ **a**[Cambridge, Mass.] **c**Harvard Univ. **P.** **d**1981
(Vendi i botimit nuk ndodhet në burimin e të dhënave në njësi, për këtë arsye është vendodhur në kllapa katrore. Emri i botuesit është i shkurtuar.)

2.

210 □□ **a**Brampton [Cumbria] **c**L.Y.T.C. **d**[1978 or 1979]
(Vendi i botimi nuk është mjaftueshëm i njohur, për këtë arsye është shtuar emri i qarkut. Viti i botimit nuk është i sigurt.)

3.

210 □□ **a**Nottigham [i.e. Nottingham] **c**[s. n.] **d**1966 **g**Sherwood Printers
(Emri i vendit të botimit është i shënuar gabimisht, ndërsa botuesi nuk është shënuar fare. E dhëna për botuesin është e detyrueshme; nëse kjo e dhënë nuk ekziston vendoset shkurtesa "[s. n.]" ose termi përkatës në shkrim jolatin.)

4.

210 □□ **a**London **b**(52, St. George's Avenue, N7) **c**St. George's Church **d**[1975]
(Në regjistrim është shënuar edhe adresa e botuesit. Viti i botimit nuk ndodhet në burimin e të dhënave, për këtë arsye është vendosur brenda kllapave katrore.)

5.

210 □□ **a**Colorado Springs **c**Myles **a**London **c**Houseman [distributor] **d**1980
(Në njësi janë dy botues. Në nënfushën c, në kllapa është shënuar funksioni i shpërndarësit.)

6.

210 □□ **a**London **c**Macmillan for the Linnean Society **d**1964-
(Njësia botohet më shumë se një vit, për këtë arsye është shënuar viti i parë dhe viza.)

7.

210 □□ **a**London **a**Boston **c**Butterworth **d**cop. 1982
(Njësia është botuar në dy vende të ndryshme. Viti i të drejtës së autorit (copyright) është shënuar me shkurtesën cop.)

8.

210 □□ **a**Ipswich **c**Boydell P. **a**Bungay **c**Waveney Publications **d**1976
(Në njësi janë dy botues.)

9.

210 □□ **a**[S. l. cs. n.] **d**1974 **e**Manchester **g**Unity Press
(Në njësi janë vetëm të dhënat për shtypshkronjën, për këtë arsye në nënfushat a dhe c, në kllapa katrore janë shënuar shkurtesat "S. l." dhe "s. n.")

10.

210 00 aLondon [etc.] cO.U.P. d1978-1981
(Kur vendet e tjera të botimit nuk shënohen, vendoset shkurtesa "[etc.]" ose termi përkatës në shkrim jolatin. Vëllimet e veçanta të njësisë janë botuar disa vite.)

11.

210 00 aBombay c[s. n.] d1980 printing
(Në vend të vitit të botimit në njësi është viti i shtypjes, i cili vendoset në nënfushën d me shpjegimin përkatës.)

12.

210 00 aGeneva cWHO aLondon cdistributed by H.M.S.O. d1970 h1973 printing
(Kur në kolofon është edhe funksioni i shpërndarësit, e dhëna vendoset në tërësi. Kur viti i shtypjes ndryshon nga viti i botimit, shpjegimi përkatës bëhet në nënfushën h.)

13.

210 00 aBern cBundeskanzlei a= Berne cChancellerie fédérale d1974
(Vendi i botimit dhe emri i botuesit në njësi janë në dy gjuhë. Para të dhënave paralele vendoset shenja e barazimit dhe hapsirë "= ".)

14.

210 00 aA Paris cChez l'auteur dAvec Privilège du Roy, 1700
(Në njësi është vetëm viti i privilegjit.)

15.

210 01 aVenezia cAntonio Vivaldi d1716
(Dorëshkrimi i Vivaldit është krijuar në Venecia në vitin 1716.)

16.

210 01 aNapoli cLuigi Marescalchi d[2nd half of 18th cent.]
(Dorëshkrim i konservatorit të Milanit nga gjysma e shekullit të 18-të.)

17.

210 01 aAlcobaça cMosteiro de Santa Maria d1495
(Dorëshkrim i krijuar në shtypshkronjën e manastirit Santa Maria.)

18.

210 00 aOxford cUniversity Press aAmsterdam cElsevier d1970-
 210 00 aOxford cUniversity Press aAmsterdam cElsevier d1970-1975
 210 00 aLondon cPergamon aAmsterdam cElsevier d1975-1979
 210 00 aOxford cPergamon aAmsterdam cElsevier d1980-1990
 210 10 aAmsterdam cElsevier d1990-
(Në fushat e përsëritshme 210 vendosen ndryshimet te vendi i botimit dhe te botuesi, si dhe periudha përkatëse e botimit për burimin në vazhdim.)

19.

210 00 aGjakovë cMuzeu i Qytetit të Gjakovës d1978-
 210 00 aGjakovë cMuzeu i Qytetit të Gjakovës d1978-1980
 210 00 aPejë cMuzeu i Pejës d1991-1992
 210 10 aPrishtinë cShoqata e Muzeve të Kosovës d1993-
(Serialin Muzeu nga viti 1993 e boton Shoqata e Muzeve të Kosovës në Prishtinë. Botuesi i parë, midis viteve 1978 dhe 1980, ka qenë Muzeu i Qytetit të Gjakovës,

ndërsa botuesi i ndërmjetëm ka qenë Muzeu i Pejës nga Peja midis viteve 1991 dhe 1992.)

20.

210 □□ **a**Tiranë **c**Shoqata e Minatorëve të Republikës së Shqipërisë **d**1954-1986
 210 0□ **a**Tiranë **c**Shoqata e Minatorëve të RP të Shqipërisë **d**1954-1962
 210 0□ **a**Tiranë **c**Shoqata e Minatorëve të RS të Shqipërisë **d**1963-1977
 210 1□ **a**Durrës **c**Shoqata e Minatorëve RS **d**1978-1986
(Seriali Ljevarstvo nuk botohet më. Botuesi i parë, midis viteve 1954 dhe 1962 ka qenë Shoqata e Minatorëve të Republikës së Shqipërisë në Tiranë, ndërsa botuesi i fundit midis viteve 1978 dhe 1986, kur botimi ka ndaluar së botuari, ka qenë Shoqata e Minatorëve RS nga Durrësi. Botuesi i vetëm i ndërmjetëm ka qenë Shoqata e Minatorëve të RS të Shqipërisë në Tiranë midis viteve 1963 dhe 1977.)

21.

210 □□ **a**Paris **c**Elsevier **d**1989-
 210 0□ **a**Paris **c**Elsevier **d**1989-1999
 210 1□ **a**Les Ulis **c**EDP Sciences **d**2000-

22.

210 □□ **a**Paris **c**CNRS, Centre de documentation sciences humaines **d**1977-
 210 0□ **a**Paris **c**CNRS, Centre de documentation sciences humaines **d**1977-1981
 210 0□ **a**Paris **c**Société française d'histoire des sciences et techniques **d**1982-1997
 210 1□ **a**Fontenay-aux-Roses **c**ENS éd. **d**1998-

23. * COBISS.net

210 □□ **a**Prishtinë **b**Rruga "Agim Ramadani" 305, Prishtinë **c**Toena **d**2003
(Në njësi është edhe adresa e botuesit.)

24. *

100 □□ **bd** **c**1966
 210 □□ **a**University Park (Pa.) **c**Pennsylvania State University, Department of Slavic Languages **d**1966
(Vendi i botimit nuk është mjaftueshëm i njohur, për këtë arsye është shënuar shteti federal amerikan. E dhëna është marrë nga burimi i të dhënave, për këtë arsye është brenda kllapave katrore. Kur botuesi është së bashku me institucionin kryesor (suprem), të dhënat vendosen në atë renditje siç janë në njësi. Viti në nënfushën 210d duhet të përputhet me vitin në nënfushën 100c.)

25. *

102 □□ **afra** **agbr** **ausa**
 210 □□ **a**Paris **a**Londres **a**New York **c**Gordon & Breach **d**1974
(Në njësi ndodhen tre vende botimi. Të dhënat në nënfushat a duhet të përputhen me të dhënat e koduara në fushën 102.)

26. *

100 □□ **bf** **c**1999 **d**2000
 210 □□ **a**Piran **c**Pomorski muzej "Sergej Mašera" **a**= Pirano **c**Museo del mare "Sergej Mašera" **d**[1999 ali 2000] **e**Ljubljana **g**"Jože Moškrič" **h**2000
(Viti i botimit nuk dihet. Në nënfushën 100c shënohet viti më i hershëm, ndërsa në 100d viti më i vonë i mundshëm. Emri i personit që është pjesë e emrit të shtëpisë botuese ose shtypshkronjës vendoset brenda thonjzave. Vendi i botimit dhe emri i botuesit janë në dy gjuhë. Para të dhënave paralele vendoset shenja e barazimit dhe hapësirë "=".)

Shfaqja në formatin ISBD:

Piran : Muzeo detar "Sergej Mašera" = Pirano : Museo del mare "Sergej Mašera", [1999 ose 2000] (Ljubljana : "Jože Moškrič", 2000)

27. * COBISS.net

210 □□ **a**Tiranë **c**Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Shqipërisë **c**= Anstalt zum Schutz des Kulturerbes von Albanien **c**= Institute for the Protection of Cultural Heritage of Albania **d**2002 **e**[Tiranë] **g**Dea
(Emri i botuesit është në tri gjuhë. Para të dhënave paralele vendoset shenja e barazimit dhe hapësirë "=" . Vendi i prodhimit nuk ndodhet në burimin e të dhënave, për këtë arsye është brenda kllapave.)

Shfaqja në formatin ISBD:

Tiranë : Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Shqipërisë = Anstalt zum Schutz des Kulturerbes von Albanien = Institute for the Protection of Cultural Heritage of Albania, 2002 ([Tiranë] : Dea)

28. * COBISS.net

210 □□ **a**Prishtinë **c**Shoqata e Stomatologëve të Kosovës **a**[Ferizaj] **c**Infograf [distributor] **d**2001 **e**Prishtinë **g**Rilindja
(Në njësi është botuesi dhe distributori. Në nënfushën c, në kllapa katrore është vendosur e dhëna për funksionin e distributorit.)

29. *

210 □□ **a**[S. l. cs. n.] **d**1951
(Në njësi nuk ka të dhëna për vendin e botimit dhe botuesin, për këtë arsye në kllapa katrore shënohen shkurtesat "S. l." in "s. n.")

30. * COBISS.net

210 □□ **a**Prizren **c**vetëbot. **d**1993 **e**Prizren **f**Ulpiana 8 **g**Eurota
(Në njësi shënon "vetëbotues", ndërsa në nënfushën c termi shkurtohet në vetëbot. Në njësi është edhe adresa e prodhuesit.)

31. * COBISS.net

210 □□ **a**Shkodër **c**[A. Vinca] **d**2002
(Autorët e punimeve të diplomës, tezave të doktoratës etj. llogariten si botues individual; emri vetjak shkurtohet dhe vendoset brenda kllapave.)

32. * COBISS.net

100 □□ **bg** **c**1971 **d**1997
 210 □□ **a**Prishtinë **c**Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës **d**1971-<1997>
 215 □□ **a**Vëll. <1-2> **d**24 cm
(Vëllimet e veçanta të monografisë botohen disa vite. Botimi ende nuk ka dalë në tërësi, për këtë arsye viti i dytë në nënfushën 210d vendoset në kllapa këndore. Pasi të pranohet edhe vëllimi i fundit kllapat fshihen. Vitet në nënfushën 210d duhet të përputhen me vitet në nënfushat 100c dhe d.)

33. * COBISS.net

100 □□ **bg** **c**2001 **d**9999
 210 □□ **a**Tiranë **c**Buzuku **d**2001-
 215 □□ **a**Vëll. <1-> **c**ilustr. **d**24 cm

(Ka dalë vetëm vëllimi i parë i monografisë që do të botohet disa vite. Në nënfushën 210d shënohet viti dhe viza. Viti në 210d duhet të përputhet me vitin në nënfushën 100c. Në nënfushën 100d shënohet "9999".)

34. * COBISS.net

100 UU **bh c2000 d1999**
 210 UU **aKorçë cDitura d2000, cop. 1999 eKorçë gColograf**
(Kur në njësi është edhe viti i botimit edhe i të drejtës së autorit (copyright), fillimisht vendoset viti i botimit dhe pastaj copyright me simbolin përkatës.)

35. * COBISS.net

100 UU **be c1994 d1584**
 210 UU **aTirana cDitura d1994 eTirana g"Daniela Bregu"**
 324 UU **aBot. origj.: Wittemberg, 1584**
(Te përshkrimi i një faksimile në fushën 210 vendosen të dhënat për rishtypjen dhe jo të dhënat për botimin origjinal. E dhëna në nënfushën 210d duhet të përputhet me të dhënë në nënfushën 100c. Viti i botimit i origjinalit shënohet në nënfushën 100d.)

36. *

210 UU **aLabaci cimpensis Michaelis Promberger d1773 eLabaci gliteris Egerianis**
 620 UU **dLjubljana**
(Vendi i botimit në njësi është i shënuar në formë të vjetër. Për të mundësuar kërkimin edhe me formën moderne të emrit të vendit të botimit, ai duhet të vendoset në nënfushën 620d.)

37. *

100 UU **bh c1992**
 102 UU **ausa**
 210 UU **aBerkeley [etc.] cUniversity of California Press dcop. 1992**
(Kur në njësi janë më shumë se tri vende të botimit, shënohet vetëm i pari dhe më pas shkurtesa "[etc.]" ose termi përkatës në shkrim jolatin. E dhëna e koduar në fushën 102 ka të bëjë me vendin e vendosur në nënfushën 210a.)

38. * COBISS.net

100 UU **bg c1952 d1955**
 210 UU **aGjilan cDrita d1952-1955 eGjilan g"Denis Mjaku"**
(Botimi ka përfunduar, ndërsa vëllimet e veçanta janë botuar për disa vite. Të dhënat në nënfushën 210d duhet të përputhen me të dhënat në fushën 100. Emri i personit që është pjesë e emrit të prodhuesit shënohet në formën e plotë dhe brenda thonjëza.)

39. * COBISS.net

210 UU **aElbasan cLibri cToena aLezhë cRilindja d2002 eShkup gGrafika**
(Në njësi janë tre botues me seli në dy vende të ndryshme.)

40. * COBISS.net

001 UU **7cb**
 210 UU **aБеоград[б.и.] d1921 eБеоградг"Вук Караџић"**
(Shkrimi i katalogimit është cirilik serb (kodi në nënfushën 0017). Në njësi nuk ndodhet botuesi, për këtë arsye në nënfushën c është vendosur shkurtesa "[b. i.]".)

41. *

001 UU **7cc**

102	uu	amkd
210	uu	a Скопје[и др.] сПросветно дело[идр.] d1988 eБјеловаргПросвета <i>(Shkrimi i katalogimit është cirilik maqedon (kodi në nënfushën 0017). Në njësi ndodhen më shumë se tri vende botimi ose botues, për këtë arsye është shënuar vetëm i pari dhe është shtuar shkurtesa "[i dr.]".)</i>

42. * COBISS.net

001	uu	7cc
210	uu	a СтругасСтрушки вечери на поезијатас=Soirées poétiques de Struga d1981 eКумановогПросвета <i>(Shkrimi i katalogimit është cirilik maqedon (kodi në nënfushën 0017). Emri i botuesit në njësi është në dy gjuhë dhe në dy lloje shkrimesh. Para të dhënave paralele shënohet shenja e barazimit dhe hapësirë "= ").</i>

43. * COBISS.net

210	uu	a Tiranë c Shoqata e Fizioterapistëve të Shqipërisë d 1992-
210	0u	a Tiranë c Shoqata e Fizioterapistëve të Shqipërisë d 1992-2016
210	1u	a Tiranë c Lidhja e Fizioterapistëve të Shqipërisë d 2016- <i>(Revistën Fizioterpia fillimisht e ka botuar Shoqata e Fizioterapistëve të Shqipërisë, ndërsa më vonë Lidhja e Fizioterapistëve të Shqipërisë. Në fushën e parë 210 vendosen të dhënat nga zona e 4-të e ISBD-së. Më pas shtohen edhe dy fusha 210 dhe në to vendosen të dhënat për çdo botues veç e veç.)</i>

44. * COBISS.net

210	uu	a Durrës c Geni d 1971-
210	0u	a Durrës c Geni d 1971-2011
210	0u	a Durrës c Salomon d 2011-2015
210	1u	a Durrës c Ari Media d 2016-
300	uu	a Nga 26.8.2015 deri më 6.6.2016 revista nuk është botuar <i>(Në fushën e parë 210 vendosen të dhënat për botuesin në përputhje me ISBD-në. Më pas në fushat 210 vendosen të dhënat për secilin botues të revistës Femra.)</i>

45. * COBISS.net

210	uu	a Prishtinë c Videotop d 2004-
210	0u	a Prishtinë c Videotop d 2004-2014
210	0u	a Ferizaj c Dea d 2014-2015
210	1u	a Ferizaj c DeaPrint d 2015- <i>(Të dhënat për botuesit e revistës Kamera digjitale.)</i>

46. * COBISS.net

210	uu	a Prizren c Drita d 1968-
210	0u	a Prizren c Drita d 1968-2011
210	0u	a Prizren c Salomon d 2011-2015
210	0u	a Prizren c Media 24 d 2015-2016
210	1u	a Gjilna c Dielli d 2016-
300	uu	a Nga 26.8.2015 deri më 5.10.2016 revista nuk është botuar <i>(Të dhënat për botuesit e revistës Stop.)</i>

47. * COBISS.net

210	uu	a Vlorë c Dielli d 1971-
210	0u	a Vlorë c Dielli d 1971-[201-]
210	0u	a Vlorë c Fishta d [201-]-2015
210	1u	a Vlorë c Mekuli d 2016-

(Emrat e të gjithë botuesve dihen, ndërsa nga vitet e botimit saktë dihet vetëm viti i parë.)